



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI I LËNDËS
Metodologji e Përkthimit

Ngarkesa: 3 Kredite - (= 30 orë mësimore); **Leksione:** 1.5 Kredite - (= 15 orë mësimore);
Seminare: 1.5 Kredite - (= 15 orë mësimore);
Viti / Semestri : Viti I, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Master i Shkencave, Përkthim Teknik-letrar dhe Interpretim
Kodi i etikës: Kodi i Etikës, Universiteti i Tiranës (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

T'u sigurojë studentëve njohuri dhe instrumente teorike e metodologjike të nevojshme për përvojën reale të përkthimit. Të ndërtojë bazën e kuptimit kritik dhe reflektimit mbi sfidat e përkthimit dhe praktikën profesionale në fushën e përkthimit. Të nxisë ndërgjegjësimin mbi parimet, procedurat dhe standardet e praktikës së mirë përkthimore në kontekst shumëdisiplinor.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të njohin dhe analizojnë zonat problematike specifike të studimeve përkthimore dhe sfidat praktike të përkthimit.
2. Të aplikojnë instrumentet teorike dhe metodologjike në analizën kritike të praktikës përkthimore.
3. Të kuptojnë dhe vlerësojnë funksionin dhe statusin e teksteve në bashkëlidhje me strategjitë dhe metodat përkthimore.

Rezultatet e pritshme:

Në përfundim të kursit, studentët do të jenë në gjendje të

1. Ndërgjegjësohen për dallimet gjuhësore dhe kulturore që ndikojnë në procesin e përkthimit.
2. Kuptojnë funksionet specifike të llojeve të ndryshme tekstore në kontekste të ndryshme komunikimi.
3. Reagojnë në mënyrë kritike dhe të pavarur ndaj materialeve për detyra të ndryshme përkthimore.